



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/263

Datë: 23.04.2019

Procesverbal

i mbledhjes se III (e tretë) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/159 datë:12.02.2019, për miratimin e Planit Komunal të veprimtimit për Eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021.
4. Debat rreth raportit të pasurisë publike të Komunës së Malishevës.
5. Shqyrtimi i kërkesave.
6. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë:21.03.2019, filloj në ora 11, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e tretë, jemi pak me vonesë sepse mbledhjen e kemi thirr për datën 20 por Raimonda ka kërkuar që sot ta mbajmë. Rendin e ditës e keni nëse s'keni diçka, kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për 4 anëtar prezent.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Unanimisht ishin për 4 anëtar prezent

2. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2018.

Hashim Vrenezi: Për këtë raport deshta me hy në analizë pasi që gjërat po përsëriten, sepse kishte disa gjëra të reja. E mira është se në të hyrat vetanake ka rritje pra ka përmirësim. Te Policia gjërat ishin te rritura edhe pse ne vazhdimisht kemi pas vërejtje se pse nga qendra pragu i të hyrave është limituar në nivel lokal. Te shpenzimet në mallra dhe shërbime janë në rritje spo kemi sqarime, shërbime kontraktuese tjera e që ka keqpërdorime të mëdha e që duhet me kanë një auditim i thellë. Të bëhet kërkesa për çka janë shpenzuar te shpenzimet kontraktuese tjera. Tabela e shpenzimeve sipas Drejtorive, Drejtoria për Inspektorat nuk ka kod buxhetor si Drejtori, pra prej cilit kod paguhet kjo Drejtori, sepse po bie si me kanë ilegalisht si drejtori.

Pse të mjetet në shpenzime kapitale janë bërë shpenzime kurse punët nuk janë krye si Ujësjiellësi në fshatin Marali, rruga "Mulla Selimi", me vendimin e Kuvendit për bartje të mjeteve nga viti 2016, 2017 në vitin 2018 në cilat projekte janë shpenzuar këto mjete, kur dihet se Kuvendi ka vendosur ato mjete të shpenzohen për kanalizim në fshatin Marali, dhe në Lagjen e re në Malishevë. Ngjashëm është edhe me fushën e sportit në fshatin Shkozë e realisht sa punu asgjë, pastaj në rrjet të kanalizimit në Marali, aty i kanë bërë vetëm do shpime por ujësjiellës nuk ka.

Raimonda Krasniqi: Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatra, në cilat fshatra janë shpenzuar 70.000 euro, pastaj punimi i rrethojave të shkollave në cilat shkolla dhe në cilat fshatra janë ndërtuar ato rrethoja.

Alban Krasniqi: Vendimi i miratuar të mjeteve për kompensimin e tri pagave për mësimdhënës dua të dijë ku kanë përfunduar ato mjete, sepse DKA ka heziturar mu marrë me këtë çështje a mos janë shpenzuar diku tjetër ato mjete. Aktvendimi i Kryetarit të Komunës i datës: 26.10.2018 përmes të cilit janë bartur mjetet, cilat janë ato mjete që janë bartur nga një projekt në projektin tjetër, nga një program në programin tjetër të specifikohet në cilat linja janë bartur. Te rrjetet e kanalizimit sa janë kryer, ku janë krye dhe sa metra, të këtë specifikim të projekteve dhe niveli i zbatimit të tyre.

Mjetet për ndërtimin e minitransitit në Malishevë janë paraqitur si mjete të shpenzuara, të jepen sqarime kur dihet se asgjë nuk është punuar në këtë drejtim, pastaj të lagja Veselaj në Banjë, sepse 93 mijë euro janë të hyra vetanake. Kuvendi për projektet brenda përgjegjësisë tonë spo kemi informata.

Rrahim Morina: Kush jeni këtë raport ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/159 datë:12.02.2019, për miratimin e Planit Komunal të veprimit për Eficiencë të energjisë (PKVEE) 2019-2021.

Çlirim Karaqica: Drejtoria për Urbanizim me kanë caktuar te merrem me këtë plan të veprimit, ky plan a bërë për 5 projekte sidomos sa i përket konsumit me të madh të energjisë për 20 objekte të Kuvendit Komunal, QKMF, ne Gjimnaz dhe shkollën fillore në Pagarushë që kemi konsum me te madh të energjisë elektrike për këto që u ceken.

Alban Krasniqi: Ne kemi pas edhe më herët këtë plan emërtimi është i njëjtë në parim është dashtë të miratohet por auditim në asnjë institucion sa i përket shpenzimit të energjisë nuk kish pas, dhe çdo ndërtim publik që behët është dashtë te bazohet në këtë plan, sa a zbatuar ky plan më herët dhe tani janë disa projekte për ndriçim, a bazohen në këtë plan të eficiencës.

Çlirim Karaqica: Dritat led janë të teknologjisë së fundit që me to kursehet energjia.

Hashim Vrenezi: Eficienca nënkupton që me rrymë elektrike mu ngrohë sa më pak, dritat mu vendose akumuluese led dhe objektet me kanë të izoluar e që nënkupton me pas sa me pak shpenzim të energjisë ose me pas të vendosura edhe panele solare.

Çlirim Karaqica: Limiti për shpenzim është 20%, ky plan është i specifikuar.

Alban Krasniqi: Deri në mbledhje sigurova që ska mbivendosje të terminologjisë dhe mos i ka skaduar afati atij planit që ka qenë.

Rrahim Morina: Mos po duplikohet si plan duhet të dimë apo ky të bëhet si aneks plan? Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Debat rreth raportit të pasurisë publike të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Me qene se një pjesë të materialit e kemi nëse jeni te pajtimit e shtyjmë për një mbledhje tjetër. Unanimisht ishin që kjo pikë të shtyhet.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.06/12 datë:09.02.2019 të parashtruar për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nga Imset Rudi nga Panorci.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/14 datë:08.02.2019 të parashtruar nga Baki Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/22 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Bahte Bytyqi nga fshati Shkozë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/31 datë:18.03.2019 të parashtruar nga Blerim Krasniqi nga fshati Llashkadrenoc, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rrahim Morina: Unë për këto kërkesa kam kërkuar sqarime nga drejtoritë përkatëse në shkresa.

Alban Krasniqi: Në shkresën e drejtorie nuk ceket edhe rregullorja që kemi miratuar për ndërrim destinimet, pra të përmirësohen këto e pastaj ne të marrim vendim.

Rrahim Morina: Ne t'i rekomandojmë deri në mbledhje kërkojmë nga drejtoritë që ato shkresa t'i plotëson. I kemi 5 kërkesa për ndërrim destinim, kush jeni t'i rekomandojmë? Unanimisht ishin për.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/158 datë:12.03.2019 të parashtruar nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve, për caktimin e zonës së mbrojtur të Memorialit të UÇK-së në kodrën e quajtur Golesh në

Malishevë.

Alban Krasniqi: Unë kam qene pjesë kur e kemi vendosur memorialin e UÇK-së, disa qytetar na kanë ndihmuar. Tash po kërkojmë që ajo zonë atje të jetë zonë e mbrojtur që nesër mos të mundet aty dikush me ndërtuar diçka. Atje munden mu mbjell pisha, mu vendosur karrige.

Hashim Vrenezi: Nëse dikush tenton me ndërtuar apo me ba diçka atje duhet me kërkuar leje sepse është pronë publike, dhe kur a vendosura ai memorial aty a keni marrë leje, sepse edhe ne jemi për.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Shqyrtimi i kërkesës nr.02/164 datë: 13.03.2019 të parashtruar nga e fshatit Llazicë, Vermicë dhe Drenoc.

Alban Krasniqi: Ata banor aty kanë problem në kycje të rrugës e duhet me shku me larg gati në Mleqan për mu kyç në rruge e tash dikund për 100 metra po kërkojnë me zgjidh këtë problem.

Rrahim Morina: Po e rekomandojmë për Kuvend e kërkojmë sqarime nga Drejtoria për Urbanizëm , Unanimisht ishin për.

Shqyrtim i kërkesës nr.02/131 datë:11.03.2019 të parashtruar nga banorët e lagjes Brahaj nga fshatit Carrallukë.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/123 datë: 28.02.2019 e parashtruar nga Rukije Zulfaj.

Alban Krasniqi: A mundemi ta kërkojmë një pikë në Kuvend për te gjitha rastet që kanë nevojë për strehim.

Hashim Vrenezi: Këto kërkesa për ndërtim te shtëpive munden me hy edhe nga subvencionet.

Rrahim Morina: Kush jeni që te rekomandohet kjo si pikë për debat ne kuvend për te gjitha rastet? Unanimisht ishin për.

Kërkesa e Valmire Gashit nga fshati Vermicë.

Rrahim Morina: Kjo po kërkon meja dhanë një pjesë në shfrytëzim, Agush Gashi nga ky fshat ka bërë padi dhe kjo lëndë është në Gjykatë. Kush jeni që këtë kërkesë te përcjellim Kryetarit të Komunës për trajtim te mëtutjeshëm.

Unanimisht ishin për t'i përcillet kërkesa Kryetarit.

Alban Krasniqi: Për pikat që ska material mos të futen në rend të ditës.

Rrahim Morina: E kemi një kërkesë për ndërtim të Xhamisë në Terpezë të Poshtme në KPF kemi kërkuar dokumente shtesë ata kanë thënë nuk ju sjellim se po përdorni standarde të dyfishta.

Alban Krasniqi: Nëse ne kemi kërkuar dokumente shtesë e ata nuk kanë sjellë mos te futet në rend të ditës.

Rrahim Morina: Unë po e hedh në votim kush jeni të futet kjo kërkesë në Kuvend? Për ishin 3, kundër 2.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:30 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

